



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2019:250072

Datë: 12.02.2024

Numri i dokumentit: 05312315

C.nr.676/2019

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Nazmi Neziri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve nga Prishtina, kundër të paditurit Z. A. nr. personal ..., nga Podujeva, me objekt kontesti Rimbursimin e dëmit me vlerë të kontestit prej 215.00 eurove, jashtë shqyrtimit gjyqësor më datën 12.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- Për shkak të padëgjueshmërisë/mosbindjes -

APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve nga Prishtina, dhe:

DETYROHET i padituri Z. A. nga Podujeva, që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar (të dëmtuarit V. Sh.), në aksidentin e datës 30.03.2018, t'ia paguajë shumën prej 215.00 (dyqind e pesëmbëdhjetë) eurove, me kamatën ligjore të cilën e paguajnë Bankat Komerciale në Kosovë, për mjete të deponuara në afat mbi një vit, e pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 20 eurove, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja, me datën 30.10.2019 ka paraqitur padi kundër të paditurit për Rimbursimin e dëmit, duke theksuar se i padituri me datën 30.03.2018, rreth orës 19:38 h, në Podujevë, duke drejtuar automjetin Yamaha, pa targa të regjistrimit, i cili në atë moment ishte pa mbulesë siguroese, respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit shkakton aksidentin në komunikacion, duke i shkaktuar dëm të dëmtuarit V. Sh.

Bazuar në Ligjin nr.04/L-018 për sigurim të detyrueshëm nga auto përgjegjësia neni 18 dhe në respektim të dispozitave të LMD-së, Byroja Kosovare e Sigurimeve është e obliguar që dëmet në raste të tilla t'ia kompensoi të dëmtuarit dhe të njëjtin ta rimbursoj (regresoj) nga shkaktari i aksidentit, respektivisht nga i padituri në rastin konkret.

Andaj, i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave ta aprovojë kërkesëpadinë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi më datën 15.11.2023, të cilin i padituri e ka pranuar me datën 16.01.2024 (e cila është konfirmuar përmes fletëkthesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës). Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurin për detyrimin ligjor për dhënie të përgjegjës në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes.

I padituri, pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ka gjetur së në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë nga neni 150 paragrafi 1 pikat a), b) dhe (c) të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK-së), nëse të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Gjykata në kuptim të dispozitave të cituara nga neni 150 i LPK-së, e në lidhje me dispozitat nga neni 18 paragrafi 4, i Ligjit për Sigurim të Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, me të cilin përcaktohet se: *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat.”*, dhe dispozitës së nenit 8, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku përcaktohet se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit.”*, si dhe nenin 245, paragrafi 1 i të të njëjtit ligj, ku përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.”*, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kamatëvonesa është vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 382 të LMD-së.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara u referohet taksave gjyqësore në shumë prej 20 eurove.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.676/2019, me datën 12.02.2024**

Gjyqtari:
Nazmi Neziri

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.

Ankesa është e lejuar vetëm për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave materiale neni 491 të LPK-së.